



INFORMACIONE TË SHKURTRA

Periudhat e regjistrimit

Periudha e vitit kur mund të regjistroheni në një plan shëndetësor varet nga lloji i planit shëndetësor për të cilin kualifikoheni.



Në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov



Me telefon në numrin 1-855-355-5777

**TTY
1-800-662-1220**



Takoni një asistent personal

Në programet dhe veprimtaritë e saj shëndetësore, "NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, gjinisë, moshës apo aftësisë së kufizuar.

Përse duhet të regjistroheni në një plan shëndetësor nëpërmjet "NY State of Health"?

Arsyet e regjistrimit për sigurim shëndetësor janë të shumta dhe "NY State of Health" e lehtëson kërkimin dhe regjistrimin për mbulim gjithëpërfshirës me kosto të ulët. Mund të zgjidhni nga një shumëllojshmëri planesh shëndetësore. Mund të merrni ndihmë nga një asistent i trajnuar. Dhe, mund të kualifikoheni për mbulim falas ose për ndihmë për të paguar mbulimin tuaj.

Çfarë lloje planesh ofron "NY State of Health"?

"NY State of Health" është vendi ku mund të kërkoni dhe të regjistroheni për "Medicaid", "Child Health Plus", planin bazë dhe planet e kualifikuara shëndetësore.

Kur mund të regjistrohem?

Koha e regjistrimit varet nga programi për të cilin kualifikoheni, i cili bazohet mbi moshën, të ardhurat dhe faktorë të tjerë. Regjistrimi është i hapur gjatë të gjithë vitit nëse kualifikoheni për:

- Medicaid
- Child Health Plus
- Planin bazë

Mund të regjistroheni në një plan të kualifikuar shëndetësor gjatë periudhës vjetore të regjistrimit të hapur ose, nëse kualifikoheni, në një periudhë regjistrimi të veçantë.

Indigjenët e Amerikës dhe të Alaskës mund të regjistrohen në çdo kohë gjatë vitit për çdo program të "NY State of Health".

Çfarë është periudha e regjistrimit të hapur?

Periudha e regjistrimit të hapur është një kohë e kufizuar e vitit – zakonisht nga nëntori deri në janar – gjatë së cilës mund të regjistroheni për një plan të kualifikuar shëndetësor. Nëse nuk regjistroheni gjatë këtyre muajve, duhet të prisni deri në periudhën vijuese të regjistrimit të hapur. Ka disa përjashtime. Mund të regjistroheni në planin e kualifikuar shëndetësor jashtë periudhës së regjistrimit të hapur nëse kualifikoheni për periudhën e regjistrimit të veçantë.

Çfarë është periudha e regjistrimit të veçantë?

Periudha e regjistrimit të veçantë është periudha gjatë së cilës një person përjeton një ngjarje të veçantë jetësore (e quajtur "ngjarje jetësore kualifikuese"), e cila i mundëson regjistrimin ose ndërrimin e mbulimit nëpërmjet një plani të kualifikuar shëndetësor jashtë periudhës së regjistrimit të hapur.

Cilat janë ngjarjet jetësore kualifikuese që mund ta kualifikojnë një person për periudhën e regjistrimit të veçantë?

Në ngjarjet jetësore kualifikuese përfshihen:

- Humbja e sigurimit shëndetësor (për arsye të ndryshme nga mospagesa e primit)
- Shpërngulja e përhershme në shtetin e Nju-Jorkut ose brenda tij, gjë që ju mundëson ofrimin e planeve të reja shëndetësore
- Martesa ose bashkëjetesa (duhet të keni pasur një tjetër mbulim brenda 60 ditëve të fundit)
- Divorci ose ndarja ligjore
- Shtatzënia e vërtetuar nga një mjek i përgjithshëm
- Lindja ose adoptimi i një fëmije, ose zhvendosja e një fëmije në një qendër kujdestarie
- Kualifikimi ose moskualifikimi për ndihmën për të paguar për mbulimin e planit tuaj të kualifikuar shëndetësor
- Marrja e shtetësisë, kombësisë ose statusit të rezidentit të ligjshëm

Në përgjithësi, ju duhet t'ia raportoni "NY State of Health" ngjarjen jetësore kualifikuese brenda 60 ditëve. Mund t'ju nevojitet të paraqisni prova për ngjarjen jetësore kualifikuese në planin e ri shëndetësor ose në "NY State of Health".

Si do ta di se për cilin program kualifikohem?

Ka tri mënyra të thjeshta për të zbuluar nëse kualifikoheni për mbulim shëndetësor:

- Aplikoni në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov
- Telefononi qendrën e shërbimit të klientit në numrin 1-855-355-5777
- Takoni një



Në internet në adresën
nystateofhealth.ny.gov



Me telefon në numrin
1-855-355-5777

TTY
1-800-662-1220



Takoni një asistent personal

Do t'ju udhëzojmë në lidhje me procesin e regjistrimit, do t'ju informojmë mbi programin për të cilin kualifikoheni, si dhe për kohën e regjistrimit. Ofrohet ndihmë në çfarëdo gjuhe që flisni.